

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. M., nga fshati T., Komuna e N., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat Xh. H., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrolle, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti për Krime të Rënda PP.I. nr. 160/2017, të datës 24.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 02.11.2017, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari N. M., nga i ati H., dhe nëna Sh., e lindur C., i lindur ..., në fshatin T., Komuna e N., ku edhe jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së ... ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Se nga viti 1998 në shtëpinë e tij në fshatin T., Komuna e N., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit, ashtu që me datë 18.07.2017, rreth orës 09,00 Njësitë i Hetimeve Rajonale në Gjilan, e njofton të akuzuarin lidhur me urdhëresën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, UGJK nr. 69/17 të datës 17.07.2017, për bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse, me ç' rast i njëjti deklaroi se posedon një armë automatike tip ... e kalibrit ... me numër serik ... dhe një karikator me ... fishekë të kalibrit ... arma dhe municioni i lartcekur konfiskohen nga zyrtarët policor të NJHR në Gjilan.

Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrolle, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 42, 51, 53, 69, 73, 114 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK-ës dhe neneve 365, dhe 453 të KPPRK-ës.

## **E G J Y K O N**

*Të akuzuarin N. M., me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, të cilin dënim burgu i akuzuari nuk do ta mbaj nëse në periudhën e verifikimit prej 2. (dy) viteve nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të revokohet,*

*Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës automatike tip kallashnikov AK – 47 e kalibrit 7.62 x 39 me numër serik 14221270 dhe një karikator me 3 fishekë të kalibrit 7.62 x 39.*

*Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

### **Arsyetim**

*Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP nr. 160/2017, të datës 24.08.2017, kundër të akuzuarit N. M. nga fshati T., Komuna e N., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1. të KPK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.*

*Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Agron Uka, në shqyrtimin gjyqësor fillimisht mbeti në tërësi pran aktakuzë e më pas shtoi se pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi në seancën e sotme kërkoi nga Gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të njëjtit të i merr parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese edhe ato lehtësuese si peshën e veprës penale, gjendjen e rëndë ekonomike, nuk evidentohet në dosje kriminale, më parë nuk është ndeshur me ligjin, ka pranuar fajësinë që në fillim të seancës së sotme është penduar për veprimet inkriminuese, njëkohësisht i njëjti premtion se në të ardhmen nuk do të përsërisë një gjë të tillë. Andaj, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit të i merr parasysh të gjitha këto rrethana ashtu që dënimi të jetë në proporcion me peshën dhe natyrën e veprës.*

*Mbrojtësi i të N. M., avokat Xh. H. deklaroi meqë i mbrojturi im N. M. e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe këtë e ka bërë pa kurrfarë presioni ose detyrimi, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese se është i gjendjes së varfër ekonomike, mbajtës i familjes, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet që mos të kryej vepra tjera penale, sjellja e tij korrekte si në procedurën parapenale dhe në këtë seancë, kërkojmë nga Gjykata që mundësisht të i shqiptohet një dënim më i butë.*

*I akuzuari N. M., deklaroi se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, më vjen keq për veprën e kryer penale, armën pa kurrfarë problemi ja kam dorëzuar organeve të rendit. Andaj, propozoi Gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të but që është e mundur.*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në veçanti, foto dokumentacionin, procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave i dt. 18.07.2017 si dhe me vet*

pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari N. M. nga viti 1998 në shtëpinë e tij në fshatin T., Komuna e N., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit, ashtu që me datë 18.07.2017, rreth orës 09,00 Njësi i Hetimeve Rajonale në Gjilan, e njofton të pandehurin lidhur me urdhëresën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan, UGJK nr. 69/17 të datës 17.07.2017, për bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse, ku i akuzuari deklaroi se posedon: një armë automatike ... e kalibrit ... me numër serik ... dhe një karikator me ... fishekë të kalibrit ... arma dhe municioni i lartcekur konfiskohen nga zyrtarët policor të NJHR në Gjilan. Ashtu që në këtë mënyrë i njëjti e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për të akuzuarin N. M., Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, është mbajtës i familjes dhe është në gjendje të dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit të veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i armës automatike tip kallashnikov AK – 47 e kalibrit 7.62 x 39 me numër serik 14221270 dhe një karikator me 3 fishekë të kalibrit 7.62 x 39, është bazuar në nenin 69 par.1 dhe 374 par. 3 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
P.nr. 173/17 Me datë. 02.11.2017**

**Sekretare juridike,**  
Naile Neziri

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.